



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUPRSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
AKADEMIA E DREJTËSISË  
AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE

Njësia. Org.  
Org. Jedin.  
Org. Unit

02

Nr. Prot.  
Br. Prot.  
Prot. No.

408

Nr. Faqeve  
Br. Stranica  
No. Pages

03

Data  
Datum  
Date

19.09.2019

Prishtinë / a

Republic of Kosovo  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUPRSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Br.No. 01 / 371  
19.09.2019  
PRISHTINE

## Memorandum Mirëkuptimi

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Republika e Kosovës

dhe

Akademia e Drejtësisë (AD), Republika e Kosovës

**Për përcaktimin e politikave për trajnime dhe lejimin e qasjes në bazën elektronike të të dhënave**

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Akademisë së Drejtësisë (AD), vendosja e bashkëpunimit për të realizuar mandatin ligjor në mbështetje të të dy institucioneve në çështjet e fushëveprimit të përbashkët.

Bashkëpunimi reciprok i të dy palëve nënshkruese bëhet me qëllim të mbështetjes së procesit të avancimit profesional të sistemit gjyqësor si dhe lehtësimit të zhvillimeve të programeve të trajnimit.

### Neni 2 Fushëveprimi

Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e informatave dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnime, përcaktimin e politikave trajnuese, zbatimin e programit të trajnimeve, pjesëmarrjen në trajnime, shkëmbimin e të dhënave për trajnimet e realizuara dhe pjesëmarrësit, si dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve.

### Neni 3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të angazhohet:

-Në vlerësimin e nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe stafit administrativ dhe të njoftoj AD-së me rezultatet e këtij procesi;

- Të propozoj tema dhe programe trajnimi për trajnimin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ;
- Të hartoj politikat e trajnimeve për të përcaktuar parimet bazë për organizimin e trajnimeve dhe do të njoftoj AD-në;
- Të mbështesë AD-në me hartimin e listave të pjesëmarrësve në trajnime specifike;
- Të jap udhëzime për organizimin e trajnimeve specifike;
- Për procesin e vlerësimit të ndikimit të trajnimeve, në raste të caktuara.

#### **Neni 4**

#### **Akademia e Drejtësisë**

Akademia e Drejtësisë do angazhohet që:

- Të përfshihet KGJK në procesin e hartimit të programit të trajnimeve;
- Të përfshijë në programin e trajnimeve propozimet e KGJK-së;
- Të përfshijë gjyqtarët dhe stafin e kualifikuar – trajnues - të sistemit gjyqësor në zbatimin e trajnimeve për anëtarët e sistemit gjyqësor në harmoni me ligjet dhe aktet nënligjore të AD për përzgjedhjen dhe angazhimin e trajnuesve;
- Të jap informata KGJK-së sipas kërkesave, për organizimin e trajnimeve dhe pjesëmarrjen në trajnime;
- Të njoftoj KGJK-në për të gjitha programet jashtë vendit të organizuara nga AD dhe të marrë mendimin e KGJK-së për gjyqtarët që duhet të marrin pjesë në këto trajnime, në përputhje me programin dhe kompetencat e gjyqtarëve apo stafit.

#### **Neni 5**

#### **Qasja në bazën elektronike të të dhënave**

KGJK dhe AD pajtohen që të lejohet qasja për kryetarët e gjykatave dhe stafin e KGJK-së në bazën elektronike të të dhënave të AD-së. Qasja do të jetë vetëm për lexim dhe printim (pa mundësi të ndryshimit apo plotësimit të të dhënave) dhe do të shërbej për monitorimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnime dhe programe tjera të AD-së.

Gjatë këtij procesi duhet të mbrohen të dhënat personale dhe konfidenciale sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 6**

#### **Ndryshimi i këtij Memorandumi**

Çfarëdo ndryshimi i këtij memorandumi do të bëhet me pëlqimin e të dy palëve dhe në formë të shkruar.

#### **Neni 7**

#### **Kohëzgjatja**

Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga dy palët dhe do të zgjasë deri në ndërprerjen e tij nga palët.

**Neni 8**  
**Ndërprerja**

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndërpritet me paralajmërimin e cilës do palë duke ofruar njoftim me shkrim një muaj më parë tek pala tjetër:

**Neni 9**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

**Neni 10**  
**Nënshkrimi i Memorandumit**

Ky memorandum nënshkruhet nga palët, pasi të jetë vendosur lidhur me të nga KGJK, ndërsa fillon se zbatuari ditën e nënshkrimit të tij.

Memorandumi nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për secilën palë.

Për KGJK,

Skender Çoçaj,  
Kryesues,  
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Për AD,

Luljete Hetemi,  
UD Drejtoresh Ekzekutive,  
Akademia e Drejtësisë



---

Prishtinë, datë 19 Shtator 2019